



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 19/04/2023 Ref.: 531/23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31, nenit 7 dhe 15 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, si dhe Manualin e Akreditimit (*përditësuar me vendimin Ref.932/22*), Këshilli Shtetëror i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në mbledhjen e 111-të, të mbajtur më 14.04.2023, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë në nivel institucional, për periudhën pesë (5) vjeçare (1 tetor 2023 - 30 shtator 2028).
- II. Obligohet Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më datë 15.11.2023 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1854/22, datë 31.10.2022, pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 13.03.2023, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Milan Pol, Joke Denekens, Jadranka Pelikan.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë është vlerësuar se përmbushë: plotësisht shtatë (7) standarde dhe substancialisht katër (4) standarde. Duke ju referuar standardeve të plotësuara Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka rekomanduar që Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë të riakreditohet për periudhën pesë (5) vjeçare, nga 1 tetor 2023 deri me 30 shtator 2028.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 111 të mbajtur më 14.04.2023 ka shqyrtuar kërkesën e Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar.*

Vendimi ju dërgohet :

- Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë